VENDIM
Nr. 363, datë 29.5.2019

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDRYSHUESE TË MARRËVESHJES SË HUAS (DATË 30 QERSHOR 2008, MARRËVESHJE HUAJE NR.ABA-P3), NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS JAPONEZE PËR BASHKËPUNIM NDËRKOMBËTAR (TË ZËVENDËSUAR NGA AGJENCIA JAPONEZE E BASHKËPUNIMIT NDËRKOMBËTAR, NË TETOR 2008), PËR PROJEKTIN "PËRMIRËSIMI I SISTEMIT TË KANALIZIMEVE PËR TIRANËN E MADHE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 19 e 23, të ligjit nr. 43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huas (datë 30 qershor 2008, marrëveshje huaje nr. ABA-P3), ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar (të zëvendësuar nga Agjencia Japoneze e Bashkëpunimit Ndërkombëtar, në tetor 2008), për projektin "Përmirësimi i sistemit të kanalizimeve për Tiranën e madhe", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

Agjencia Japoneze e Bashkëpunimit Ndërkombëtar

Drejtuar: Shkëlqesisë së Saj, Znj. Anila Demaj
Ministre e Financave dhe Ekonomisë

Data: 8.2.2019
Ref nr. JICA (BK) 2-08001

Lënda: Amendimi i Marrëveshjes së Huas për Projektin "Përmirësimi i Sistemit të Kanalizimeve në Tiranën e Madhe" ndërmjet Bankës Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar, (e ndjekur në tetor 2008 nga Agjencia Japoneze e Bashkëpunimit Ndërkombëtar) dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, datë 30 qershor 2008 (Marrëveshja e Huas nr. ABA-P3) – Rialokimi i fondeve nga huaja

Shkëlqesia Juaj,

Duke iu referuar letrës suaj të datës 28 dhjetor 2018 (ref. juaj nr. 14538/4 prot.) dhe të datës 28 janar 2019 (ref. juaj nr. 1385 prot.) dhe letrës sonë të datës 9 janar 2019 (ref. jonë nr. JICA (BK) 1-08001, në lidhje me kërkesën për rialokimin e fondeve nga huaja, po iu ridërgoj këtë shkresë dhe me anë të saj bie dakord se:

1. Tabela për alokimin e të Ardhurave të Huas që është pjesë e seksionit 1 të skedulit 2 të Marrëveshjes së Huas të lartpërmendur, zëvendësohet sipas tabelës bashkëlidhur kësaj shkrese.

2. Ky ndryshim hyn në fuqi nga data kur JICA njoftohet se ka përfunduar procedura e nevojshme për hyrjen në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

3. Kjo shkresë nuk interpretohet për të autorizuar ndonjë ndryshim tjetër përveç atij të lartpërmendur.

Ju lutem, konfirmoni miratimin tuaj për amendamentin e mësipërm duke nënshkruar dy kopje të kësaj shkrese, duke ruajtur një kopje për të dhënat tuaja dhe një kopje për ta kthyer te ne.

Me respekt,
Hideya Kobayashi

Përfaqësues kryesor
Zyra Ballkanike JICA

Konfirmuar:
Në datën: 22/5/2019

QEVERIA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Nga: _____
Znj. Anila DENAJ
Ministre e Financave dhe Ekonomisë

Në vëmendje të: z. Tedi Bushaj, Drejtoria e Marrëveshjeve dhe Ofrimit të Ndihmës së Huaj, Drejtoria e Koordinimit dhe Ofrimit të Ndihmës së Huaj, Drejtoria e Përgjithshme e Borxhit Publik dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj,

Z. Arben Skënderi, drejtor i përgjithshëm, Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë,

Z. Takema Sakamoto, drejtor i përgjithshëm, Departamenti i Evropës dhe Lindjes së Mesme

Dokument bashkëlidhur

Skeduli 1

Alokimi i të ardhurave të huas

Seksioni 1. Alokimi

Kategoria	**Shuma e Huas së Alokuar**	**% e Shpenzimeve për t'u financuar**
A. Punimet Civile dhe Prokurimi i Mallrave	9,157,146,940	100%
B. Shërbimet e konsulencës	1,636,853,060	100%
C. Interesi gjatë ndërtimit	232,000,000	
i. në lidhje me A dhe E	231,000,000	
ii. në lidhje me B	1,000,000	
D. Kontigjencat	0	
E. Pagesa e angazhimit	95,000,000	
Totali	**11,121,000,000**	